

WORKSHOP “Via Egnatia – potencial zhvillimi ekonomik, parë si aset turistik”

Në vazhden e aktiviteteve me Bordin Këshillimor të Biznesit, Sektori i Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI-t, në bashkëpunim me shoqatën AST Group, zhvilloi aktivitetin për studentët me temë: “Via Egnatia – potencial zhvillimi ekonomik, parë si aset turistik”.



Z.Artur Guni, Trainer dhe Menaxher zhvillimi pranë Shoqatës AST Group, njëherësh edhe nënkryetar i Bashkisë Elbasan, paraqiti fillimisht një historik të shkurtër të Rrugës “Egnatia”, itinerarin e kësaj rruge si edhe rëndësinë që ka patur ajo. Ai shtoi se Shoqata e Alpinizmit Skive dhe Turizmit malor, e cila operon në treg prej 12 vitesh, nëpërmjet guidave me turistë vendas e sidomos me ata të huaj, po promovon më së miri Rrugën “Egnatia” duke e kthyer potencialisht në një atraksion turistik.



U ftuan të gjithë studentët e interesuar, veçanërisht ata të programit të studimit Operator Turistik, dhe Operator Turistik në Gjuhë Gjermane, të regjistrohen në kurset e trajnimit për guidë turistike që ofron AST Group, me qëllim përfitimin e eksperiencës dhe punësimit e tyre në të ardhmen.

